



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KAMËZ

**KONTRATË PËR DHËNIEN ME KONCESION/PPP TË
SHËRBIMIT TË PASTRIMIT, GRUMBULLIMIT,
TRANSPORTIMIT DHE SELEKSIONIMIT TË MBETJEVE
URBANE PËR QYTETIN E KAMZËS**



Bashkia Kamëz 2018

REPUBLIKA E SHQIPERISE
ZYRA E NOTERISE

NR. 102 Rep. Uro

NR. 486/s Kol



**KONTRATË PËR DHËNIEN ME KONCESION/PPP TË SHËRRIMIT TË PASTRIMIT,
GRUMBULLIMIT, TRANSPORTIMIT DHE SELEKSIONIMIT TË MBETJEVE URBANE
PËR QYTETIN E KAMËZËS**

Në zyrë Noteriale, më datë 23, muaji Maj, viti 2018 (dy mijë e tetëmbëdhjetë), para
mijë noter Armando K. Kodra, anëtar i dhomës së Noterisë Uro, me adresë
Uro Hasler, u paraqitën palët kontraktuese si më poshtë:

BAS KIA KAMËZ, që më poshtë do të quhet “**AUTORITET KONTRAKTUES**”, përcaktuar si
i tillë në bazë të nenit 13 të Ligjit 125/2013 “Për koncesionet dhe Partneritetin Publik Privat” i
ndryshuar, përfaqësuar me autorizim nga Sekretari i Përgjithshëm Z. Qemal Çejku;

DHE

Bashkimi i përkohshëm i shoqërive/shoqëria “ALKO IMPEX GENERAL CONSTRUCTION”
dshh dhe “2T” shpk, që në vijim do të quhet “**KONCESIONARI**”, i formuar sipas marrëveshjes
nr.2285 Kol, nr.2973 Rep, datë 13.04.2018 me këto te dhena:

Shoqëria “ALKO IMPEX GENERAL CONSTRUCTION” dshh, e cila figuron e rregjistruar si
person juridik ne QKR me NIPT K91326028I dhe date 26.01.2009 regjistrimi;

Shoqëria “2T” shpk, e cila figuron e rregjistruar si person juridik ne QKR me NIPT K01731001M
dhe date 31.05.2000 regjistrimi;

Shoqëritë e mësipërme përfaqësohen në këtë kontratë nga Z. Taulant Godroli, i biri i ____, lindur në
Tiranë dt. dhe me banim , referuar Prokurës së Posacme Nr. 3814 Rep. nr .
3119 Kol dt. 11.05.2018, për identitetin e të cilit u sigurova nga

Palët lidhin këtë kontratë konçesioni bazuar në Ligjin nr.125/2013 “Për koncesionet dhe
partneritetin publik privat” i ndryshuar, dhe në Vendimin e Këshillit të
10.07.2013, “Për miratimin e rregullave për vlerësimin dhe dhënie me koncesion/partneritet publik
privat”, i ndryshuar, Kodi Civil i Republikës se dhe bien dakord për sa

- 2.6.1. Kërkesat e Autoritetit Kontraktues në procedurën konkurruese;
- 2.6.2. Oferta e Koncesionarit;
- 2.6.3. Dispozitat e kësaj kontrate;
- 2.6.4. Çdo Aneks tjetër dhe shtojcat e tyre;
- 2.6.5. Çdo dokument tjetër që i referohemi në këtë Kontrate ose çdo dokument tjetër bashkëlidhur kësaj Kontrate.



Neni 2 **Objekti i Koncesionit/PPP**

Me anë të kësaj kontrate Autoriteti Kontraktues në bazë të ligjit “Për konçesionet dhe Partneritetin Publik Privat” i ndryshuar, i jep Koncesionarit të drejtën për:

Financimin, vënien në punë të shërbimit të pastrimit, grumbullimit, transportit dhe seleksionimit të mbetjeve urbane nëpërmjet impiantit të diferencimit të mbetjeve për qytetin e Kamzës, depozitimin e mbetjeve në vendet përkatëse dhe transferimin e shërbimit nga Koncesionari tek Autoriteti Kontraktues, konform kushteve dhe afateve të kësaj kontrate.

Neni 3 **Karakteristikat e shërbimit**

3.1. Shërbimi i pastrimit, grumbullimit, transportimit dhe seleksionimit të mbetjeve urbane nëpërmjet impiantit të diferencimit të mbetjeve do të zhvillohet në qytetin e Kamzës, me këto karakteristika:

- Grumbullimi dhe transportimi i mbetjeve urbane dhe tregjeve;
- Larje dhe dezinfektimi i kontejnerëve;
- Mirëmbajtje të vendgrumbullimeve të mbetjeve gjatë ditës;
- Grumbullimi i mbetjeve ndërtimore dhe të vëllimshme;
- Fshirja e rrugëve dhe trotuareve me krahë;
- Fshirje e rrugëve me makineri;
- Larje e rrugëve njëherë në ditë;
- Ndërtimi i stacionit të transferimit dhe Instalimi i impiantit të diferencimit të mbetjeve;
- Transportimi dhe depozitimi i mbetjeve në vendet përkatëse të miratuara nga autoritetet përkatëse.

Një kopje e aktit të themelimit, statutit dhe regjistrimit të shoqërisë së re si person juridik, do të dorëzohet Autoritetit Kontraktues b 30 ditëve nga data e regjistrimit, për të marrë miratimin e këtij të fundit, duke patur parasysh që miratimi i këtij të fundit të jepet brenda 10 ditëve nga data e paraqitjes së dokumentit përkatës. Në rast vonese për shprehjen e miratimit, konsiderohet se Autoriteti Kontraktues nuk ka vërtetë apo sugjerime në lidhje me themelimin e personit të ri juridik. Në mënyrë veçanëse kërkohet që në përmbajtjen e Statutit të përfshihen të paktën:

- i. Forma e shoqërisë: Forma e shoqërisë do të jetë “shoqëri me përgjegjësi të kufizuar” ose “shoqëri aksionere”, duke funksionuar në zbatim të ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”;
 - ii. Objekti i shoqërisë: Shërbimi i pastrimit, grumbullimit, transportit dhe seleksionimit të mbetjeve urbane nëpërmjet ndërtimit të impiantit të diferencimit për qytetin e Kamzës dhe transferimi te autoriteti kontraktor. Shoqëria koncesionare (SPV) nuk do të ushtrojë asnjë lloj tjetër veprimtarie tregtare përveç atyre të cilat janë përcaktuar në objektin ekësaj Kontrate;
 - iii. Kohëzgjatja: Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin e saj në përputhje me afatin e kësaj Kontrate Koncesioni/ppp;
 - iv. Themeluesi i shoqërisë: Shoqëria e re do të themelohet vetem nga Koncesionari.
- 8.2. Të marrë të gjitha lejet dhe licencat e nevojshme për realizimin e kësaj kontrate në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi.
 - 8.3. Të pajiset me Leje Mjedisore përkatëse për realizimin e kësaj kontrate në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi brenda 90 ditëve nga data e hyrjes në fuqi e kësaj kontrate.
 - 8.4. Të realizojë investimet e parashikuara sipas afateve të përcaktuara dhe me cilësinë e kërkuar në këtë Kontratë;
 - 8.5. Të zbatojë projektin për Shërbimi i pastrimit, grumbullimit, transportit dhe seleksionimit të mbetjeve urbane si dhe ndërtimit të impiantit të diferencimit për qytetin e Kamzës sipas specifikimeve të përcaktuara në kërkesat e autoritetit kontraktues dhe ofertën fituese;
 - 8.6. Të ketë në çdo kohë në gatishmëri, gjatë gjithë kohëzgjatjes së kontratës, të gjitha mjetet dhe pajisjet e kërkuara nga kontrata në përputhje me specifikimet teknike dhe ofertën e paraqitur në tender. Në rast se përdorimi i një pjese të mjeteve dhe pajisjeve është i pamundur për shkaqe teknike për zona ose pika të caktuara, Koncesionari mund të ndryshojë një pjesë të mjeteve dhe pajisjeve vetëm pas verifikimit dhe miratimit nga Autoriteti Kontraktues të pengesave teknike.
 - 8.7. Të administrojë projektin për periudhën e koncesionit/ppp;
 - 8.8. Të parandalojë dhe kontrollojë çdo ndotje mjedisore të shkaktuar nga ndonjë punim i tij dhe të kthejë ambientin, me shpenzimet e veta, në situatën e mëparshme (para ndotjes).
 - 8.9. Të përballojë të gjitha shpenzimet që lidhen me dëmet që eventualisht mund t'i shkaktohen Autoritetit Kontraktues apo palëve të treta.
 - 8.10. Të mbajë të informuar Autoritetin Kontraktues për çdo rrethanë që mund të ketë ndikim në ecurinë e projektit;
 - 8.11. Të marrë masa për të garantuar respektimin e dispozitave të Kodit të Punës dhe rregulloreve përkatëse të sigurimit teknik, të disiplinës teknike, të mbrojtjes në punë, të higjienës dhe sigurimit nga zjarri, për të parandaluar çdo dëm e fatkeq “si n” punë.

- 8.12. Në veprimtarinë e tij të zbatojë legjislacionin shqiptar në fuqi;
- 8.13. Të paguajë të gjitha shpenzimet për publikimet e bëra, si dhe shpenzimet noteriale.
- 8.14. Konçesionari nuk do të paguajë taksat vendore për shërbimet që lidhen me përdorimin të sipërfaqes së tokës që do t'i vihet në dispozicion nga autoriteti Kontraktor, sipas parashikimeve të nenit 5.2 të kësaj kontrate.
- 8.15. Konçesionari është i detyruar të paguaj 10.0% të taksave vendore që lidhen me ndërtimin e stacionit të transferimit.
- 8.16. Konçesionari merr përsipër të integrojë në shoqërinë e re koncesionare punonjësit e Ndërmarrjes së Pastrim-Gjellbërimit të cilët kryejnë aktualisht shërbimin e pastrimit në qytetin e Kamzës.
- 8.17. Koncesionari do të marrë përsipër koston mbi depozitimin e mbetjeve urbane apo inerte.

Neni 9

Vlerësimi i Investimeve dhe vlera e kontratës

- 9.1. Mbi bazën e të dhënave të (projektit) ofertës, vlera e ofertës së paraqitur nga Konçesionari në këtë procedurë Konçesioni janë sipas Aneksit nr. 1 "Formulari i Ofertës", bashkëlidhur.
- 9.2. Vlera e kontratës është e përbërë nga vlera totale e pagesave që do të kryejë autoriteti kontraktues për gjatë gjithë kohëzgjatjes së kontratës për kryerjen e Shërbimit të pastrimit, grumbullimit, transportimit dhe seleksionimit të mbetjeve urbane nëpërmjet ndërtimit të impiantit të diferencimit e cila është e barabartë me 1 350 000 000 (një miliard e treqind e pesëdhjetë milion) lekë pa TVSH.

Neni 10

Programi punimeve

Konçesionari merr përsipër të zbatojë programin e mëposhtëm kohor të punimeve :

- 10.1. Konçesionari merr përsipër të verë në punë stacionin e transferimit për seleksionimin e mbetjeve brenda 6 muajve nga dita e hyrjes në fuqi e kësaj kontrate.
- 10.2. Konçesionari merr përsipër të fillojë menjehërë nga dita e nesërme ora 00:01, kryerjen e shërbimit të Pastrimit, Grumbullimit dhe Transportimit dhe depozitimit të mbetjeve sipas zërave të përcaktuar në Ankesin 2 të kësaj Kontrate.
- 10.3. Afati i kryerjes së shërbimit të Pastrimit, Grumbullimit, Transportimit dhe depozitimit të mbetjeve është 365 ditë në vit x 12 vjet nga data e lidhjes së kontratës .

Neni 11
Testimi i veprës

- 11.1. Në përfundim të punimeve (stacioni i transferimit), duhet të kryhet testimi i veprës, për të siguruar funksionimin e shërbimit.
- 11.2. Ky testim do të kryhet nën kontrollin e një grupi punë, në përbërje të të cilit do të ketë përfaqësues të Autoritetit Kontraktues dhe të Konçesionarit, të cilët do të konkludojnë me një raport përfundimtar për vënien ose jo në punë të impiantit të administrimit të mbetjeve dhe shërbimeve të tjera.
- 11.3. Në rast mospjesëmarrjeje të Autoritetit Kontraktues gjatë testimit, Konçesionari ka të drejtë të kryejë vetë testimin dhe vënien në punë të veprës, duke njoftuar Autoritetin me shkrim, brenda 30 ditëve nga testimi dhe vënia në punë.

Neni 12
Zgjidhja e Kontratës së Koncesionit/PPP

12.1. Zgjidhja e njëanshme e kontratës nga Autoriteti Kontraktues.

Autoriteti Kontraktues ka të drejtë të zgjidhë kontratën:

- 12.1.1. Kur Konçesionari nuk vendos në punë stacionin e transferimit për seleksionimin e mbetjeve sipas pikës 10.1 të kësaj kontrate. Në këtë rast Autoriteti Kontraktues ka të drejtë të marrë vlerën e Sigurimit të Kontratës të parashikuar në Nenin 14.
- 12.1.2. Në rast të mosrealizimit të pastrimit të qytetit sipas grafikut të parashikuar në ofertë dhe në specifikimet teknike të autoritetit kontraktor për më shumë se 5 ditë të njëpasnjëshme, si dhe në rast të mosrealizimit të stacionit të transferimit sipas projektzbatimit të miratuar nga Autoriteti Kontraktor.
- 12.1.3. Kur Konçesionari transferon aksionet/kuotat e Shoqërisë së re koncesionare tek të tretët, pa miratim të Autoritetit Kontraktues;
- 12.1.4. Kur Konçesionari braktis punimet e zbatimit për ndërtimin e impiantit për më shumë se 30 (ditë) ditë të njëpasnjëshme. Në këtë rast Autoriteti Kontraktues ka të drejtë të marrë vlerën e Sigurimit të Kontratës të parashikuar në nenin 14, truallin dhe të gjitha asetet që përdoren për pastrimin dhe administrimin e mbetjeve siç është në momentin e braktisjes, pa patur asnjë detyrim të çdo lloji karshi koncesionarit apo shoqërisë koncesionare.
- 12.1.5. Kur shoqëria e re koncesionare është në proces falimentimi dhe/ose likuidimi në paafesi paguese ose situata të tjera të ngjashme, Autoriteti Kontraktues ka të drejtë të marrë vlerën e Sigurimit të Kontratës të parashikuar në nenin 14.
- 12.1.6. Kur Konçesionari nuk zbaton në mënyrë të përsëritur një/diçka nga detyrimet e tij të parashikuara në këtë Kontratë. Për të shmangur çdo keqkuptim sot e në të ardhmen mospërbushje e përsëritur e detyrimeve të Konçesionarit do të konsiderohen ato

mospërbushje të cilat janë shkaktuar për faj të koncesionarit dhe që bëjnë të pamundur vijim e kontratës dhe që konsiderohen të rënda.

Zgjidhja e njëanshme e kontratës nuk çliron Koncesionarin nga detyrimi për të vazhduar zbatimin e detyrimeve që kanë të bëjnë me dorëzimin e impiantit dhe shërbimeve tek Autoriteti Kontraktues. Palët bien dakord që dorëzimi do të bëhet brenda një afati kohor prej 30 ditësh, duke filluar nga momenti i zgjidhjes.

Nëse ky detyrim nuk përbushet nga Koncesionari atëherë, Autoriteti Kontraktues, ka të drejtë të marrë përsipër përkohësisht administrimin e impiantit dhe shërbimit, për sigurimin e një shërbimi të efektshëm dhe të pandërprerë.

12.2. Zgjidhja e njëanshme e kontratës nga Koncesionari;

Koncesionari, ka të drejtë të zgjidhë këtë Kontratë kur Autoriteti Kontraktues është në shkelje serioze të detyrimeve të tij kontraktore dhe nuk e korrigjon këtë shkelje, brenda afatit të përcaktuar në pikën 12.4 të këtij neni.

12.3. Zgjidhja e kontratës nga secila palë;

Secila nga palët ka të drejtë të zgjidhë kontratën kur:

12.3.1. Megjithë plotësimin e kriterëve nga ana e Koncesionarit për aplikim për leje, licenca ne përputhje me legjislacionin në fuqi dhe ndërhyrjen e Autoritetit Kontraktues, koncesionari nuk është pajisur me to për arsye ligjore, për fillimin e punimeve dhe/ose operimin e Projektit.

12.3.2. Vazhdimi i saj behet i pamundur jo për faj të koncesionarit.

12.3.3. Në rastet e parashikuara nga neni 20 pika 20.3 e kësaj kontrate.

12.4. Njoftimi i zgjidhjes së kontratës

Secila nga Palët që kërkon zgjidhjen e kësaj Kontrate në përputhje me këtë nen, do të njoftojë paraprakisht me shkrim Palën tjetër. Njoftimi duhet të përmbajë:

- i. Detajet e duhura duke nënvizuar shkaku të zgjidhjes;
- ii. Hollësitë e llogaritjes së pagesave si rezultat i zgjidhjes së kontratës;
- iii. Çdo informacion tjetër të rëndësishëm.

12.5. Zgjidhja e kontratës me konsensus:

Palët kanë të drejtë ta zgjidhin kontratën e koncesionit/ppp me pëlqim të dyanshëm, duke negociuar mënyrën e kompensimit të investimit. Gjithësesi, Koncesionari ka të drejtë të kërkojë Sigurimin e Kontratës nëse ekziston, me kusht që të ketë paguar kompesimin e rene dakort me negociimin midis dy paleve.

12.6. Të Drejtat e Palëve Financuese dhe zëvendësimi i koncesionarit:

12.6.1. Njoftimi i Palëve Financuese:

Menjëherë pas marrjes dijeni për shkelje serioze nga ana e koncesionarit të detyrimeve kontraktore, që çenojnë zbatimin dhe operimin e koncesionit ose sjellin si pasojë zgjidhjen e

kontratës sipas pikave 12.1.2, 12.1.3, 12.1.4, 12.1.5 e 12.1.6 të nenit 12 të kësaj kontrate, Autoriteti Kontraktues përveç njoftimit të koncesionarit sipas pikës 12.4 të këtij neni, njofton edhe Palën Financuese me qëllim dhënie të një mundësie kësaj të fundit, për të ndihmuar koncesionarin për të korrigjuar ose marrë masa për të rregulluar këto shkelje brenda 30 (tridhjetë) ditësh nga data e një njoftimi të tillë. Autoriteti Kontraktues i jep Palës Financuese ndihmesë të arsyeshme për këtë qëllim.

12.6.2. Zëvendësimi i Koncesionarit

Në rast se nuk është bërë i mundur korrigjimi i shkeljes nga koncesionari, Pala Financuese (nëse e gjykon me interes) zgjedh, të ndërhyjë duke i propozuar Autoritetit Kontraktues, transferimin e Projektit në duart e një ekipi menaxherial zëvendësues ose një subjekti zëvendësues i cili duhet që të ketë, ekspertizën, aftësitë, reputacionin dhe gjëndjen financiare të paktën të barazvlershme me atë të Koncesionarit në momentin e fitimit të garës;

Në lidhje me sa më sipër, transferimi i Projektit në duart e një ekipi menaxherial zëvendësues ose një subjekti zëvendësues nuk do të kryhet pa miratimin e Autoritetit Kontraktues.

Zëvendësuesi, do të ketë të drejtën e menaxhimit/administrimit të projektit dhe do të realizojë të gjitha të drejtat dhe detyrimet e koncesionarit, por nuk do të ketë të drejtë të shesë, të transferojë, të vendosë barra siguruese mbi asetet e përdorura për realizimin e objektit të kontratës.

12.6.3. Nëse Pala Financuese vendos të mos ushtrojë të drejtat e parashikuara në këtë nen, ose nëse edhe pas ushtrimit të këtyre të drejtave nuk arrihet në një zgjidhje të arsyeshme për vashdimësinë e projektit, kontrata do të zgjidhet.

12.7. Pagesat në rast zgjidhjeje të Kontratës:

12.7.1. Pagesat e zgjidhjes së kontratës nga Autoriteti Kontraktues për faj të koncesionarit.

Ne rast të zgjidhjes së Kontratës për faj të Koncesionarit, Autoriteti Kontraktues nuk merr përsipër asnjë detyrim për pagesa ndaj Koncesionarit, pas datës së njoftimit për zgjidhjen e kontratës dhe do të mbajë sigurimin e kontratës të ngurtësuar.

12.7.2. Pagesat e zgjidhjes së kontratës nga Koncesionari për faj të Autoritetit Kontraktues.

Në rast të zgjidhjes së kontratës për faj të Autoritetit Kontraktues, ky i fundit duhet t'i paguajë koncesionarit, vlerën e investimit të kryer deri në momentin e zgjidhjes së kontratës minus vlerën e amortizimit të veprës, si dhe fitimin e munguar, që Koncesionari mund të nxirrte deri në përfundim të afatit të kësaj kontrate.

12.7.3. Pagesat e zgjidhjes së kontratës nga secila palë

Në rast zgjidhjeje të kontratës nga secila palë, sipas pikës 12.3.1 të këtij neni, Autoriteti Kontraktues nuk merr përsipër asnjë detyrim për pagesa ndaj koncesionarit.

**Neni 13
Kontratat**

- 13.1. Konçesionari ka të drejtë të lidhë kontrata sipërmarrjeje për punimeve të projektit dhe çdo lloj kontratë tjetër, me qëllim realizimin e objektit të koncesionit, duke respektuar kufizimin e vendosur në nenin 17.2 të kësaj kontrate. Në të gjitha kontratat, Konçesionari është i detyruar të respektojë kushtet e kësaj Kontrate koncesionit.

Konçesionari duhet të pajisë Autoritetin Kontraktues me informacionin e mëposhtëm për nënkontraktorin e propozuar:

- i. Emrin e tij dhe adresën;
 - ii. Qëllimet për të cilat nën-kontraktuesi i propozuar do të kontraktohet, duke përfshirë çdo shërbim që do të ofrohet nga nën-kontraktuesi i propozuar; dhe
 - iii. Vlerën e nënkontratës
 - iv. Çdo informacion i mëtejshëm i kërkuar në mënyrë të arsyeshme nga Autoriteti Kontraktues.
- 13.2. Konçesionari është përgjegjës përpara Autoritetit Kontraktues, për përmbushjen e detyrimeve nga ana e nënkontraktuesit.
- 13.3. Autoriteti Kontraktues nuk merr përsipër asnjë detyrim kundrejt sipërmarrësve, furnizuesve dhe të tretëve, në rast të mosmarrëveshjeve që mund të lindin ndërmjet këtyre të fundit dhe Koncesionarit.

**Neni 14
Sigurimi i kontratës**

- 14.1. Konçesionari, para nënshkrimit të kontratës, duhet të ketë ngurtësuar në një institucion bankar ose të sigurojë në një shoqëri sigurimesh, brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, për llogari të Autoritetit Kontraktues, një shumë prej 135 000 000 (njëqind e tridhjetë e pesë milion), që përbën 10 % të vlerës totale të kontratës. Formulari i sigurimit të kontratës është pjesë përbërëse, dhe i bashkëlidhet kësaj kontrate.
- 14.2. Konçesionarit nuk i lejohet të ç'ngurtësojë këtë vlerë pa miratimin e Autoritetit Kontraktor.
- 14.3. Sigurimi i Kontratës do të shërbejë për të garantuar zbatimin në mënyrën e duhur dhe brenda afateve të parashikuara të detyrimeve të Koncesionarit, gjatë gjithë kohëzgjatjes së kontratës.

**Neni 15
Sigurimet**

- 15.1 Konçesionari në çdo kohë do të pajiset, mbaje dhe ripërtërijë ato garanci sigurimi të kërkuara në lidhje me ushtrimin e të Drejtave Konçesionare, dhe do t'i përcjellë, ose do të kujdeset që t'i përcillen Autoritetit Kontraktues kopjet e certifikuar të çdo certifikate sigurimi pas marrjes së një njoftimi paraprak prej Autoritetit Kontraktues.
- 15.2 Konçesionari duhet të sigurojë punimet e ndërtimit/montimit të objektit dhe më pas objektin e plotë gjatë gjithë kohëzgjatjes së kontratës, të paktën nga rreziqet e parashikuara nga klasat e sigurimit 8 e 9 të nenit 7 të Ligjit 9267 dt.29.07.2004 "Për veprimtarinë e sigurimit, tëri

sigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime" gjatë gjithë periudhës së Koncesionit dhe do të dorëzojë pranë Autoritetit Kontraktues një kopje të tij çdo vit, brenda një afati 15 ditor nga data e sigurimit.

- 15.3 Në rast të dëmtimeve në fazën e ndërtimit, apo gjatë operimit të objektit vlera e dëmit e kompensuar nga siguruesi sipas kontratave përkatëse të sigurimit duhet të përdoret për të rindërtuar, riparuar, risistemuar dhe për të rikthyer objektin në gjendjen që ishte para dëmtimit. Pjesa e zbritshme nga shuma që siguruesi do të paguaje për kompensimin e dëmit do të përballohet nga Koncesionari.
- 15.4 Koncesionari duhet të sigurojë përgjegjësinë e tij për dëmtimet që mund t'u shkaktohen palëve të treta për shkak të ushtrimit të veprimtarisë.
- 15.5 Autoriteti Kontraktues do të shënohet si i bashkesiguruar në të gjitha kontratat e sigurimit.

Neni 16

Pagesat e Autoritetit dhe Tarifa Koncesionare

16.1 Pagesat e Autoritetit kontraktor

Autoriteti Kontraktor do të kryejë kundrejt Koncesionarit pagesat e Autoritetit Kontraktor sipas menyres dhe vleres së parashikuar në ofertën financiare të paraqitur nga Koncesionari, në përputhje me termet afatet dhe periudhat e parashikuara. Autoriteti Kontraktor do të vejë në dispozicion të gjithë fondet e nevojshme si dhe do të ndërmarrë procedurat e nevojshme për të garantuar pagesën për shërbimet e kryera nga Koncesionari.

Pagesat që Autoriteti Kontraktor do të detyrohet të paguaje gjatë operimit është ajo e vleres vjetore prej 1 350 000 000 [një miliard e treqind e pesëdhjetë milion] për një afat prej 12 vitesh. Pagesat vjetore kryhen në [12] këste mujore dhe për çdo këst Koncesionari lëshon faturën përkatëse në vlerën që i korrespondon periudhës për të cilën do të kryhet pagesa.

Detyrimi i Autoritetit Kontraktor për të kryer pagesën e këstit lind menjëherë pas ditës së fundit të muajit respektiv dhe pagesa duhet të kryhet brenda një afati maksimal prej 30 ditësh kalendarike nga dita e lindjes së detyrimit për kryerjen e pagesës.

Për çdo rast kur pagesa nuk kryhet në afat, atëherë mbi vlerën e këstit do të parashikohet edhe një kamatë për vonesën i përlogaritur në masën 0.5% të vlerës së këstit të paguar.

16.2. Shumat e Kundërshtuara

Kur Autoriteti Kontraktor e kundërshton pagesën e këstit duke pretenduar moskryerjen e shërbimeve dhe sipas afateve të paraqitura në ofertën e Koncesionarit, Autoriteti Kontraktor e njofton Koncesionarin në lidhje me kundërshtimet e tij me shkrim jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pune nga dita që Autoriteti Kontraktor merr faturën dhe të dhenat për shërbimet e kryera, duke deklaruar arsyet dhe çdo e id në të disponueshme që ka, për të

konfirmuar deklaratat e tij, të cilat kundërshtojnë hollësitë e paraqitura nga Konçesionari. Nëse Autoriteti Kontraktor nuk e kundërshton faturën apo shërbimet e kryera, atëherë ato konsiderohen si të pranuar; dhe

Autoriteti Kontraktor është i detyruar të paguajë çdo pjesë të vlerës së parashikuar në fature, që nuk është kundërshtuar nga Autoriteti Kontraktor. Kundërshtimet në lidhje me shërbimin dhe faturën mujore konkrete, nuk do të pengojnë palët në vazhdimin e faturimit të shërbimeve të mëposhme dhe kryerjen e pagesave përkatëse, gjithnjë nëse nuk ka kundërshtime.

Lidhur me kundërshtimet e mësipërme është detyrim i autoritetit kontraktor të provojë mosrealizimin e shërbimit të kundërshtuar.

16.2 Tarifa Konçesionare

Konçesionari duhet të paguajë për llogari të Autoritetit Kontraktues një tarifë Konçesionare të barabartë me vlerën e 1.5% të të ardhurave nga shitja e mbetjeve pas diferencimit.

Neni 17 Kufizimet

- 17.1 Për çdo transferim të aksioneve/të kapitalit themeltar të saj tek të tretët Konçesionari ose shoqëria e re konçesionare duhet të marrë pëlqimin paraprak të Autoritetit Kontraktues. Në këtë rast palës së tretë do ti transferohen dhe detyrimet apo të drejtat e përcaktuara në kontratën e konçesionit.
- 17.2 Konçesionari nuk ka të drejtë të nën kontraktoje asnjë nga detyrimet e tij sipas kësaj Kontrate, pa marrë miratimin paraprak, me shkrim, të Autoritetit Kontraktues. Për të shpallur çdo dyshim, furnizuesit e pajisjeve, materialeve dhe/ose dërgesave nuk do të konsiderohen nënkontraktore sipas kësaj Kontrate.
- 17.3 Shoqëria e re që do të krijohet, sipas nenit 8.1, dhe/ose Konçesionari nuk ka të drejtë të vendosi hipotekë, peng, apo ndonjë barrë tjetër mbi asetet që do të krijohen në zbatim të projektit të punimeve si dhe të lidhë çdo lloj marrëveshje financimi me çdo Palë Financuese. Cdo barrë apo marrëveshje financimi në lidhje me të drejtat e përcaktuara nga konçesionari i Shoqërisë Konçesionare do të bëhet me dije Autoritetit Kontraktor. Autoritetit Kontraktor për çdo pretendim duhet të bëjë me dije Konçesionarin brenda 10 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni.

Neni 18 Raportimi

- 18.1. Konçesionari është i detyruar që çdo muaj të raportojë me shkrim pranë Autoritetit Kontraktues, realizimin e programit të investimeve në vlerë dhe në natyrë dhe më pas sasinë e

administruar te mbetjeve, si dhe çdo informacion tjetër që do të konsiderohet i nevojshëm nga Autoriteti Kontraktues.

Neni 19 Legjislacioni i zbatueshëm

- 19.1. Lidhja, zbatimi dhe interpretimi i kësaj Kontrate Koncesioni do të bazohet në legjislacionin shqiptar.

Neni 20 Forca Madhore

- 20.1. “Forca madhore” nënkupton çdo rrethanë që në mënyrë të arsyeshme dhe objektive është absolutisht tej parashikimit dhe kontrollit, të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, të palës së cënuar që rezulton ose shkakton pamundësi të plotë ose të pjesshme të palës së cënuar për të përmbushur ndonjë prej detyrimeve të saj sipas kësaj kontrate (përveç kryerjes së pagesave të parave), por vetëm nëse dhe në masën që:

- a. kjo rrethanë në mënyrë objektive dhe absolute, nuk mund të parandalohet apo nuk ishte e mundur të parandalohet, shmangej ose mënjanohet nga pala e cënuar;
- b. pala e cënuar ka marrë të gjitha masat e arsyeshme paraprake, kujdesin e duhur dhe masat e arsyeshme alternative në mënyrë që të shmangte pasojën e këtij rasti në aftësinë e palës së cënuar për të përmbushur detyrimet e saj sipas kësaj kontrate dhe për të zbutur pasojat e saj;
- c. ngjarja nuk është ose nuk ka qenë pasojë e drejtpërdrejtë ose e tërthortë e shkeljes nga pala e cënuar të ndonjë prej detyrimeve të saj sipas kësaj kontrate, dhe
- d. pala e cënuar t'i ketë dhënë njoftim në afatin e rënë dakord palës tjetër (pala e pacënuar)

- 20.2. Konsiderohen Ngjarje të Forcës Madhore:

- i. Katastrofat e natyrës, përmbytjet, tërmetet, ndotje nukleare, kimike biologjike dhe çdo ngjarje e barabartë me to;
- ii. Lufta, lufta civile, konflikte të armatosura, akte terroriste, bllokada, embargo- që zgjasin për një kohë jo më të vogël se një muaj;

- 20.3. Në rastet e Forcës Madhore pala e dëmtuar duhet të njoftojë palën tjetër brenda 30 ditëve, duke i treguar dhe arsyetuar shtyrjen e përmbushjes së detyrimeve në mënyrë që të gjejnë një rrugë për të lehtësuar efektet e forcës madhore dhe të vazhdojnë kontratën.

Vonesat në përmbushjen e detyrimeve për shkak të ngjarjeve të Forcës Madhore, mund të jenë shkak për kërkesa reciproke për zhdëmtim apo për respektimin e detyrimeve kontraktore. Kufijtë e përmbushjes së detyrimeve, do të përcaktohen nga palët në marrëveshje ndërmjet tyre.

Periudha e koncesionit do të zgjatet në përputhje me nenin 4.2.2 të kësaj kontrate.

- 20.4. Zgjidhja e kontratës për shkak të forcës madhore

Pala e prekur nga forca madhore ka të drejtë të zgjidhë kontratën e koncesionit :

- i. në rast se edhe pas zbatimit të pikës 20.2 të kësaj neni, nuk është arritur një zgjidhje në të mirë të projektit,
- ii. kur forca madhore zgjat më tepër se 6 muaj

20.5. Pasojat e zgjidhjes së kontratës për shkak të forcës madhore

Në rastet e zgjidhjes së kontratës për shkak të forcës madhore, palët nuk kanë detyrime ndaj njëra tjetrës dhe secila palë do të përballojë kostot e veta.

- 20.6. Zgjidhja e mosmarrëveshje që vijnë si pasojë e forcës madhore do të bëhet në përputhje me nenin 22 të kësaj kontrate.

Neni 21

Hyrja në fuqi e Kontratës së Koncesionit

- 21.1. Kontrata e Koncesionit do të hyjë në fuqi pasi të nënshkruhet nga palët, në përputhje me Ligjin Nr.125/23013 “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, i ndryshuar.

Neni 22

Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve

- 22.1. Çdo kundërshti, mosmarrëveshje apo ankesë midis palëve kontraktuese që lind ose ka lidhje me zbatimin dhe interpretimin e kësaj Kontrate Koncesioni, do të zgjidhet me mirëkuptim midis tyre duke u bazuar në vullnetin e mirë.
- 22.2. Kur me gjithë përpjekjet e palëve nuk arrihet një konsensus i përbashkët, kompetente për zgjidhjen e çdo mosmarrëveshje që lidhet me këtë Kontratë Koncesioni, do të jetë Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tirane.
- 22.3. Fillimi apo vazhdimi i procedurave për zgjidhjen e çdo mosmarrëveshje që lidhet me këtë Kontratë Koncesioni, nuk do të pezullojë zbatimin e projektit sipas objektit të kontratës dhe nuk do të çlirojë palët nga detyrimet e marra përsipër me anë të kësaj Kontrate.

Neni 23

Sanksionet

- 23.1. Mosrespektimi i afateve dhe kushteve të kësaj Kontrate, në përfundim të periudhës të parashikuar në nenin 10 të kësaj kontrate, penalizon Koncesionarin si më poshtë:
- a) Për mosrealizimin e punimeve në përputhje me projektin e zbatimit të miratuar nga Autoriteti Kontraktor, 0.5% të kestit mujor të parashikuar.
 - b) Në rast kur nuk kryhet për faj të koncesionarit grumbullimi dhe transportimi i mbeturinave urbane dhe tregjeve sipas volumeve të punimeve të paraqitura në Aneksin 2, do zbritet vlera e punimeve të pa realizuara dhe do të aplikohet penaltet i barabartë me vlerën e punimeve të pakryera.

- c) Në rast kur nuk kryhet për faj të koncesionarit larja dhe dezinfektimi i konteniereve sipas volumeve të punimeve të paraqitura në Aneksin 2, do zbritet vlera e punimeve të pa realizuara dhe do të aplikohet penaliteti i barabartë me vlerën e punimeve të pakryera.
- d) Në rast kur nuk për faj të koncesionarit kryhet mirëmbajtja e vend grumbullimi të mbetjeve gjate dites dhe grumbullimi i mbetjeve ndertimore dhe te vellimshme (1 here ne 2 dite) sipas volumeve të punimeve të paraqitura në Aneksin 2, do zbritet vlera e punimeve të pa realizuara dhe do të aplikohet penaliteti i barabartë me vlerën e punimeve të pakryera.
- e) Në rast kur nuk kryhet për faj të koncesionarit fshirja e rrugeve dhe trotuareve me krahe sipas volumeve të punimeve të paraqitura në Aneksin 2, me trefishin e vlerës së zërit përkatës sipas studimit të fizibilitetit.
- f) Në rast kur nuk kryhet fshirja e rrugeve me makineri(1 here ne 7 dite) sipas volumeve të punimeve të paraqitura në Aneksin 2, do zbritet vlera e punimeve të pa realizuara dhe do të aplikohet penaliteti i barabartë me vlerën e punimeve të pakryera.
- g) Në rast kur nuk kryhet larja e rrugeve nje here ne dite sipas volumeve të punimeve të paraqitura në Aneksin 2, do zbritet vlera e punimeve të pa realizuara dhe do të aplikohet penaliteti i barabartë me vlerën e punimeve të pakryera.

23.2. Sanksionet paguhen në llogari të Autoritetit Kontraktues. Në rast të konstatimit të shkeljeve që çojnë në aplikimin e sanksioneve sipas këtij neni, Autoriteti Kontraktues dhe Koncesionari do të diskutojnë për një periudhe 30 ditore lidhur me shkeljen.

23.3. Kur vendoset për aplikimin e sanksionit përkatës, Autoritetit Kontraktues i lind e drejta të kërkojë shlyerjen e këtij detyrimi brenda 30 ditësh. Në rast se ky detyrim nuk shlyhet në kohë, Autoriteti Kontraktues ka të drejtë që së bashku me shlyerjen e detyrimit kryesor të kërkojë edhe kamatat ligjore.

23.4. Aplikimi dhe pagimi i penaliteteve sipas këtij neni nuk e çliron koncesionarin nga përmbushja e detyrimeve dhe parashikimeve të kësaj kontrate.

23.5. Këto penalitete do të mbahen nga Sigurimi i Kontratës parashikuar në nenin 14 më sipër, duke patur parasysh se nëse vlera e këtij sigurimi nuk është mjaftueshme për shlyerjen e penaliteteve, Koncesionari do t'a plotësojë këtë shumë, rast pas rasti.

23.6. Në rastet kur konstatohet mungesa ose dëmtimi i konteniervëve të vënë në dispozicion të përcaktuara nga specifikimet për çdo rast dhe/ose çdo shkak, Kontraktuesi është i detyruar të bëjë riparimin e tyre. Në rast se nuk kryhet riparimi i kontenierit ose zëvendësimi i tij nga ana e Kontraktorit atëherë Autoriteti Kontraktor merr masa për zëvendësimin e tij duke penalizuar Koncesionarin me vlerën e konteinerit.

Neni 24 Rregullimi i shkeljeve

24.1. Kur Autoriteti Kontraktues konstaton se gjatë periudhës së koncesionit, Koncesionari ka shkelur, ndonjë prej detyrimeve të përmendura në këtë kontratë, ai menjëherë ia bën të njohura këto shkelje Koncesionarit duke pritur për një periudhë 40 ditore përgjigjen e tij, me

argumentet përkatëse. Palët me marrëveshje të përbashkët, do të përcaktojnë mënyrën dhe afatin brenda të cilit do të rregullohet shkelja.

- 24.2. Kjo procedurë nuk e zhvesh Koncesionarin nga detyrimi për të paguar sanksione të tjera me efekte financiare që rrjedhin nga mospërbushja e detyrimeve.

Neni 25 **Transferimi i Aseteve**

- 25.1. Me mbarimin e kontratës, Koncesionari do të kryejë çdo veprim të nevojshëm për dorëzimin tek Autoriteti Kontraktues, të aseteve të marra në dorëzim nga ai, ato të realizuara nga Koncesionari gjatë periudhës së koncesionit si dhe çdo titull mbi to, të zhveshura nga çdo lloj detyrimi, barrë apo hipoteke.

Proçesi i Dorëzimit do të fillohet të paktën 6 (gjashtë) muaj përpara datës së mbarimit të Periudhës së Koncesionit me një inspektim të përbashkët të Autoritetit Kontraktues dhe Koncesionarit.

- 25.2. Koncesionari, duhet të transferojë pa kundërshtim në favor të Autoritetit Kontraktues:

- i. truallin, makineritë, paisjet;
- ii. pronësinë mbi ndërtesat apo impiantet e ndërtuara nga ai;
- iii. të drejtat kontraktore ;
- iv. dorëzimin e librave, dokumentave dhe garancive qëshoqërojnë këto asete;
- v. çdo të drejtë tjetër të fituar nga ai nëpërmjet kësaj kontrate;

- 25.3. Koncesionari, duhet të provojë se këto asete janë të mirëmbajtura dhe në gjendje të mirë pune, duke marrë parasysh normën e amortizimit përkatës.

Në rast se kontrata është zgjidhur për shkak të forcës madhore, koncesionari duhet të provojë se gjendja ekzistuese e aseteve ka ardhur si pasojë direkte e saj.

- 25.4. Çdo e drejtë që koncesionari ka fituar me këtë kontratë, do të mbarojë me transferimin e projektit.

- 25.5. Kostot e transferimit të projektit do të përballohen nga koncesionari, përveç rastit kur zgjidhja e kontratës ka ardhur për faj të Autoritetit Kontraktues.

Neni 26 **Mbarimi i kontratës**

- 26.1. Kontrata Koncesionare mbaron me përfundimin e afatit 12 vjeçar, duke patur parasysh parashikimet e nenit 4 të kësaj kontrate.

- 26.2. Mbarimi i kontratës si përfundim i afatit të saj ose në rast të zgjidhjes së parakohshme, nuk e zhvesh Koncesionarin nga detyrimi për pagimin e detyrimeve të prapambetura ndaj Autoritetit Kontraktues dhe të tretëve.

Neni 27
Konfidencialiteti

27.1. Secila nga palët duhet të konsiderojë si konfidencial të gjitha dokumentat dhe informacionet e tjera në lidhje me projektin, qofshin këto tregëti apo teknike, dhe nuk duhet t'ja bëjë të ditura një palë të tretë, të gjithë apo një pjesë të dokumentit apo informacionit, pa miratimin e palës tjetër, përveç rasteve të cilat parashikohen në legjislacionin përkatës.

Neni 28
Ndryshime

- 28.1. Kjo kontratë mund të pësojë ndryshime, shtesa dhe/ose zëvendësime vetëm me marrëveshje me shkrim të dy palëve.
- 28.2. Çdo ndryshim i kësaj kontrate apo anekseve bashkëlidhur saj, pasi të hyjë në fuqi, do të jetë pjesë përbërëse dhe e pandashme e kësaj kontrate.

Neni 29
Bashkëpunimi midis Autoritetit Kontraktues dhe Koncesionarit

Autoriteti Kontraktues dhe Koncesionari janë zotuar të bashkëpunojnë në mënyrë që të garantojnë realizimin e plotë të projektit.

Çdo komunikim për çdo problem ndërmjet palëve, do të bëhet vetëm me shkrim, në adresat e treguara më poshtë nga palët. Palët janë të detyruara t'i njoftojnë menjëherë njëra-tjetrës çdo ndryshim të secilës prej këtyre të dhënave, brenda një afati 10 (dhjete) ditor nga data e ndryshimit.

Për çdo ndihmë që do t'i kërkohet Autoritetit Kontraktues nga koncesionari, ky i fundit detyrohet të paraqesë kërkesën me shkrim për çka kërkon në zbatim të detyrimeve të kësaj Kontrate. Adresat dhe numrat e kontaktit që do të përdoren gjatë zbatimit të kësaj Marrëveshje janë:

Për Autoritetin Kontraktues

Bashkia Kamëz
.....Kamëz - Shqipëri

Për Koncesionarin

Shoqëria "ALKO IMPEX GENERAL
CONSTRUCTION" shpk.
Adresa: Rr Reshit Petrela, Kompleksi
USLUGA, Tirane

Neni 30
Regjistrimi i Kontratës

Brenda 30 ditëve nga miratimi i projektit dhe pas dorëzimit të sheshit ku do të ndërtohet stacioni i transferimit, kjo Kontratë duhet të regjistrohet në regjistrin e pasurive të paluajtshme.

Kjo kontratë u hartua në 3 (tri) kopje, në gjuhën shqipe, dhe pasi ju lexua palëve, të cilët e kuptuan dhe e pranuan atë, e nënshkruan me vullnet të lirë e të plotë, dhe në noteri e vërtetoj atë rregullisht sipas ligjit.

AUTORITETI KONTRAKTUES

Bashkia Kamëz

Përfaqësuar nga :

Sekretari Përgjithshëm

Z. Qemal Çejku



KONCESIONARI

Bashkimi i përkohshëm i
shoqërive/Shoqeria
"ALKO IMPEX GENERAL
CONSTRUCTION" shpk & "2T" shpk

Përfaqësuar nga :

z. Taulant Godroli

NOTER



Faqe 21 nga 21